REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 12131 Regj

12131

# V E N D I M
## PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me daten 13-P- 1995, une gjyqtaria e Gjykates se rrethit Tirane M. Qeda si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Xhevdet Arif Amuli, per rregjistrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar"ARIFI" SH.P.K si person juridik:

K O N S T A T O V A

Kerkuesi kerkon rregjistrimin si person juridik ne formen e nje shoqerije me pergjegjesi te kufizuar"Arifi" SH.P.K, me seli ne lagjen"Guerrile" Shkoder, me kohe- zgjatje mbi 10 vjet, me kapital themeltar e shprehur ... vleresim ne natyre ne shumen 100.000 lek, me ortak te vetm dhe me administrator Xhevdet Arif Amuli, me objekt veprimtarie:- Tregtim me shumice dhe me pakice te karburanteve, vajrave lubrifikante, pjese te ndryshme te autoveturave, tregtim te produkteve ushqimore, industriale si dhe elektro shtepijake te Eksport - Import, si dhe çdo veprimtari qe konsiderohet i pershtateshem dhe me leverdi per rritjen dhe zhvillimin e kapitalit te shoqerise.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e till duhet pranuar:

PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992" Per shoqerite tregtare" d... ligjit Nr.7667 date 28.01.1993" Per rregjistrin tregtar".

V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar"Arifi" SH.P.K, me ortak te vetem dhe administrator Xhevdet Arif Am... me objekt te veprimtarise tregtare: -Tregtim me shumice dhe me pakice t... karburanteve, vajrave lubrifikante, pjese te ndryshme te autoveturave, tregtim te produkteve ushqimore, industriale si dhe elektro shtepijake Eksport - Import, si dhe çdo veprimtari qe konsiderohet i pershtateshem dhe me leverdi per rritjen dhe zhvillimin e kapitalit te shoqerise. Seli e shoqerise do te jete ne lagjen" Guerrile" Shkoder, kapitali themeltar eshte i shprehur ne natyre ne shumen 100.000 lek, kohe- zgjatja mbi 10 vjet.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim dhe protest ne shkalle dy...

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE

NR. 12131/2

# V E N D I M

## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me daten 03-05-02 une gjyqtare M. Deda ne gjykaten e rrethit gjyqesor Tirane, pasi pashe materialet dhe kerkesen e kerkuesit Xhevdet Amuli, i cili kerkon per te bere depozitimin e vendimit nr. 2 date 29.03.2002 te Ortakut te vetem te shoqerise " Arifi " SH. P.K. dhe ;

K O N S T A T O J :

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " Arifi " SH.P.K. eshte regjistrua si person juridik me vendimin e gjykates se rrethit Tirane nr. 12131 date date 13.09.1995, me ortak te vetem e administrator z. Xhevdet Amulin, me kapital themelor 100.000 leke.

Me vendimin nr. 2 date 29.03.2002 Ortaku i vetem i shoqerise ka ndryshuar statutin e shoqerise duke shtuar kapitalin themelor ne masen 9.605 000 leke sipas vleresimi te kapitalit themelor nga eksperti kontabel. Perfundimisht kapitali themelor i shoqerise " Arifi " eshte 9.705.000 lek ku kerkuesi kerkon per te bere depozitimin e vendimit nr. 2 date 29.03. 2002 te Ortakut te vetem te shoqerise, kerkese e cila eshte e drejte dhe si tille duhet te pranohet ;

PER KETO ARESYE ;

Ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.1.1993 " Per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregetar "

V E N D O S A :

Depozitimin e vendimit nr. 2 date 29.03.2002 te Ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Arifi " SH.P.K. ne gjykaten e rrethit gjyqesor Tirane, duke bere shenimet perkatese ne regjistrin tregetar.

G j y q t a r e

Mariana Deda

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. ______/______VENDIMI
/3

**VENDIM**
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Ne Tirane, sot me date 15.06.04, une gjyqtar __________ ne Gjykaten e Shkalles se Pare, Tirane, pasi mora te shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Xhevdet Arif Amuli, dtl, 1964, lindur e banues ne Shkoder, lagja "Guerile", Administrator i pergjithshem i firmes "Arifi" sh.p.k., Shkoder, per depozimin prane rregjistrit tregtar te vendimit nr. 4 date 11 Qershor 2004 te Shoqerise Tregtare "Arifi" sh.p.k.,

**KONSTATOVA :**

Me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane nr. 12131 date 18. 9. 1995, eshte rregjistruar Shoqeria "Arifi" Sh.p.k., Shkoder, me objektin e ditur, e seli ne Shkoder, dhe me administrator dhe ortak z. Xhevdet Arif Amuli.

Ndersa me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 12131/1 date 28. 3. 2002, eshte rregjistruar vendimi i Ortakut te vetem nr. 1 date 20. 1. 2002, per caktimin e ekspertes kontabel; kurse me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 12131/2 date 3 Maj 2002, eshte rregjistruar vendimi i Ortakut te Vetem nr. 2 date 29 Mars 2003 per shtimin e kapitalit themeltar te Shoqerise.

Me vendimin e Ortakut te vetem nr. 4 date 11 Qershor 2004, eshte vendosur :

1. Miratimi e shteses se aktivitetit te Firmes "Arifi" dhe ne fushen e ndertimeve.
2. Depozitimi i ketij vendimi prane rregjistrit tregtar te Gjykates se Tiranes.

Kerkesa eshte e drejte, dhe si e tille ajo duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te ligjit nr. 7638 dt. 19. 11. 1992 "Per shoqerite tregtare", e ligjit nr. 7667 date 28. 1. 1993 " Per rregjistrimin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne rregjistrin tregtar":

**V E N D O S A**

1. Pranimin e kerkeses.
2. Depozitimin e vendimit me numer 4 date 11 Qershor 2004 te Shoqerise Tregtare "Arifi" sh.p.k., per shtese aktiviteti ne fushen e ndertimeve.
3. Te behen shenimet perkatese ne rregjistrin tregtar ne kollonen e duhur.
4. Kunder vendimit lejohet ankim.

**GJYQTAR**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT TIRANE**
**Nr** 12131/4 **Vendimi**

# V E N D I M
# I GJYQTARES SE VETME

Në Tiranë, sot me datën 12-07-2005 une Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Tiranë B. Luma, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Xhevdet Amuli, i cili kerkon depozitimin e vendimit nr 03 date 29.06.2005 te ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI " Shkoder, dhe

## KONSTATOVA

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI" Shkoder me ortak te vetem z. Xhevdet Amuli eshte e rregjistruar si person juridik me vendim te Gjykates Tirane nr 12131 date 13.09.1995 me seli ne Shkoder.
Me vendimin nr 03 date 29.06.2005 te ortakut te vetem te kesaj shoqerie eshte vendosur:
1. Emerimi konkret i Ekspertes Kontabel te Autorizuar zj.Eftali Qirjaqi
2. Ekspertja kontabel e autorizuar te vleresoje rritjen e kapitalit ne vlere te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI" Shkoder, duke transferuar nje pjese te fitimit dhe llogarine fitime te mbajtura per rritje te kapitalit themeltar.

Kerkesa e tij per te pasqyruar ndryshimet qe kane ndodhur ne shoqeri, qe te reflektohen ato edhe ne skeden perkatese te kesaj shoqerie, eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr 7667 date 28.01. 1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtar"

## V E N D O S A

Pranimin e kerkeses se kerkuesit Xhevdet Amuli, per depozitimin e vendimit nr 03 date 29.06.2005 te ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI" Shkoder, ku eshte vendosur:
1. Emerimi konkret i Ekspertes Kontabel te Autorizuar zj.Eftali Qirjaqi
2. Ekspertja kontabel e autorizuar te vleresoje rritjen e kapitalit ne vlere te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI" Shkoder, duke transferuar nje pjese te fitimit dhe llogarine fitime te mbajtura per rritje te kapitalit themeltar.
Te behen ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen________ me numer ________ si dhe te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
Blerina Luma

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr______________Vendimi

# VENDIM
## I GJYQTARES SE VETME

Në Tiranë, sot me datën 06.08 2005 une Gjyqtare në Gjykatën e Shgkalles se Parte Tiranë B. Muça, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Xhevdet Amuli, i cili kerkon depozitimin e vendimit nr 04 date 19.07.2005 te ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " ARIFI " Shkoder: dhe

## KONSTATOVA

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " ARIFI " Shkoder me ortak te vetem z. Xhevdet Amuli, eshte e rregjistruar si person juridik me vendim te Gjykates Tirane nr 12131 date 13.09.1995 me seli ne Shkoder.
Me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr 12131/4 date 12.07.2005 eshte vendosur :

1. Emerimi konkret i Ekspertes Kontabel te Autorizuar zj.Eftali Qiriaqi.
2. Ekspertja kontabel e autorizuar te vleresoje rritjen e kapitalit ne vlere te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI"Shkoder, duke transferuar nje pjese te fitimit dhe llogarine fitime te mbajtura per rritje te kapitalit themeltar

Me vendimin nr 04 date 19.07.2005 te ortakut ter vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI" eshte vendosur
1. Miratimi aktit te shtimit te kapitalit themeltar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI" Shkoder prej 7.695.000 leke.
Kerkesa e tij per te pasqyruar ndryshimet qe kane ndodhur ne shoqeri, qe te reflektohen ato edhe ne skeden perkatese te kesaj shoqerie, eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr 7667 date 28.01. 1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtar"

## VENDOSA

Pranimin e kerkeses se kerkuesit Xhevdet Amuli, per depozitimin e vendimit nr 04 date 19.07.2005 te ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Arifi " Shkoder ku eshte vendosur:
Miratimi i aktit te shtimit te kapitalit themeltar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI" Shkoder prej 7.695.000 leke.
Te behen ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen ______________ me numer rendor ___________ si dhe te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
Blerina Muça

Tiranë [illegible]

1

2. a. "Arifi" Shpk
b. Tregtim me shumicë dhe pakicë i karburanteve, vajrave lubrifikante dhe pjesëve të ndryshme për automjete, tregtimi i artikujve të ndryshëm industriale, ushqimore, pajisje të ndryshme [illegible],
c. L. "Drojë" [illegible]
ç. 100 000 lekë
Xhevdet Arifi

3. Admin i vetëm
Xhevdet Arifi [illegible] 1964

4. Kohëzgjatja 10 vjet.
An. 2 fletë
St. 4 fletë

5. a. 11-9-95
b. 9-9-95

[illegible signature]

# AKT THEMELIMI
# I SHOQERISE ME PERGJEGJËSI TE KUFIZUAR"ARIFI"SH.P.K.

Në zbatim te vendimit te ortakut te vetem Xhevdet Amuli, te shoqerise" Arifi" SH.P.K. te dates 9.9.1995 u perfundua ne perputhje me legjislacionin shqiptare në fuqi, akt themelimi i saj;

## 1 FORMIMI

1) Formimi i Shoqerise

Konstituente Xhevdet Amuli krijoj një shoqeri me pergjegjësi te kufizuar ne perputhje me kreun e katert te ligjes nr 7638dt 19.11.1992"Per shoqerite tregtare".

2) EMRI

Emri i shoqerise do te jete "Arifi" SH.P.K.

3) Qellimi dhe objekti i shoqerise

Qellimi dhe objekti i shoqerise do te jete:

tregtimi me shumice dhe pakice i karburanteve, vajrave lubrifikan pjesëve të ndryshme per automjete, tregtimi i artikujve te ndryshem industrial, ushqimore , paisjeve te ndryshme elektro-shtepiake, si dhe çdo operacion që bashkohet me veprimtarite e mesiperme dhe që konsiderohet i pershtatshëm dhe me leverdi, per rritjen dhe zhvillimin e metejshëm te shoqerise.

## KREUII

4) SELIA

Selia qendrore e selise do te jete le lagjen" Lirija" Shkoder.

Sipas vendimeve te miratuara me krijimin e shoqerise ajo mund te hape dege dhe filjale te saja në qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashte shteti.

5) Afati i shoqerise

Kohe zgjatja e shoqerise percaktohet deri me date 31.12.2005, si date e fillimit do te merret date 9.9.1995 date e nënshkrimit të akt marveshj së parë të krijimit.

6) Kapitali i Shoqerise

Kapitali themeltare i shoqerise është 100.000 leke dhe perbehet si kontribut i ortakut te vetem, që është kundravlera e një autoveture.

7) .Kapitali social ështe derdhur ne llogarinë e bankes se shtetit Shqiptare.

8) Libri i shoqerise

Per te preçizuar e saktesuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe mardheniet e punes, Shoqeria do te çel librin e vet që do te quhet

"Libri i shoqerise"

9) Viti Finaciare

Viti finaciare do te mbyllet me 31. Dhetor te vitit ne vazhdim.

II KAPITALI

Sasia e kapitalit social derdhur sipas dispozitave 6 te ketije akt marveshje do te quhet " Kontribut Kapital ".

Kontributi kapital fillimisht do te perdoret per shpenzimet fillestare te shoqerise.

2) Finacimi

Në masen e duhur shoqeria" Arifi" SH.P.K. ka te drejte te siguroje financimi tregtare, ose investuar nga çdo banke e institucionit te huaj ose shqiptare, financim ky qe do te rregullohet me anë të kontratave ose marveshjeve te veçanta.

3), Çeshtja finaciare dhe llogaria e shoqerise.

Shoqeria"Arifi" SH.P.K. do te mbajë llogari duke u mbështetur te leku shqiptare dhe te valuta e forte.

III STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHQQERISE

Qendra e shoqerise do te jete në lagjen" Lirija" Shkoder.

2) DREJTIMI I SHOQERISE

Organi me i larte drejtues do te jete ortaku i vetem.

3) ADMINISTRIMI

Shoqeria do te administrohet nga ortaku i vetem.

IV Dispozitata e fundit.

Ky akt themelimi u hartua në Tiranë me daten 9.9.1995 në tre ekzemplare në gjyhen shqipe, duke patur sejcili te njëjten vlerë.

ORTAKU I VETËM

Xhevdet Arif Amuli.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISA SHKODER

Nr repertori 1360

NR Koleksioni 972

AUTENTIFIKIM NËNSHKRIMI

Sot.me daten 9.9.1995 diten e Shtunde dhe para meje note Berhan Malevi, u paraqiten palet ortaku i vetem, per identitetin e te cilit pasi u sigurova në baze te leter njoftimit personal i vertetova nënshkrimin e aktit.

NOTERIA

Berhan Malevi.

# S T A T U T

I

SHOQERISE "ARIFI" ME PERGJEGJËSI TE KUFIZUAR .

Ky statut u perfundua në perputhje me legjislacionin në Shqiperi në fuqi, me dt 9.9.1995 në Tiranë, nga ortaku i vetem Xhevdet Amuli i datlindjes 1964 lindur dhe banues ne Shkoder, lagjen" Guerrile" duke krijuar shoqerine" Arifi" SH.P.K. imp-eks.

## KREU I

## FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1

FORMA

Zoti Xhevdet Amulii quajtur Ortak i vetem, ne permbajtjen e këtij statuti është krijuar një shoqeri me pergjegjësi të kufizuar, me legjislacionin shqiptare në fuqi dhe me dispozitat e këtijë statuti.

neni 2

EMERTIMI I SHOQERISE

~~xxxxx~~ Emertimi i shoqerise do te jete"Arifi" SH.P.K.

neni 3

SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete " ne lagjen"Lirija" Shkoder dhe me endim te ortakut te vetem mund te hapin , dege, zyre filjal ose perfaqesi në qytete te tjera te shoqerise ose jashte sa j.

Neni 4

KOHE ZGJATJA

Shoqeria do te kete një kohezgjatja mbi 10 vjet, me perjashtim te rasteve, kur perkohet kohe zgjatja ose prishja e parakoheshme.
Si dite fillestare merret dita e rregjistrimit te sajë në gjykaten e tiranes.

OBJEKTI

Shoqeria ka per objekt;
Tregtimi me shomice dhe pakice te karburanteve, të vajrave lubrifikante, pjesëve të automjeteve, tregtimin e artikujve të ndryshm, ushqim-indus, paisjeve elektroshtepiakeImp-eks dhe çdo operacion që bashkohet me veprimtarine e mesiperme dhe që konsiderohet i pershtats dhe me leverdi, per rritjen dhe zhvillimin e metejshem te shoqerise.

## KREU II

neni 6

KAPITALI THEMALTARE

kapitali themeltare është 100.000 leke dhe perbehet nga kontributi i ortakut te vetem, që konfirmohet me vlerën e autoveturës.

KREU III

Neni 7

DREJTIMI I SHOQERISE

Organi me i larte, në drejtimi e shoqerise do te jete Ortaku i vetem.

neni 8

PROCESVERBZLET

vendimete ortakut te vetem duhet heqhur ne procesverbal i cili nenshkruhet prej tijë.

neni 10

A ADMINISTRIMI

Shoqeria do te administrohet nga një administrator i vetem.

neni 11

FUQITE E ORGANIT ADMINISTRATIV

Organi administrativ ka kompetenca te gjera, që perfshinë të gji veprimtarite, e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem të shoqerise, dhe gjithçak tjeter te parashikuar me ligj.

Organi administrativ ka kompetenca:

-te marrë pjesë në ankande.

- te marrë pjesë në procedurat e falimentimit.

- te perloje kontrata dhe çdo akt tjeter juridik që ka te bej me veprimtarine e shoqerise.

- te bleje dhe këmbeje ,te tjetersoje pasuri të luajteshme te sajë dhe aksione, te themel je e të ndertoje servitute e te drejta te tjera reale.

- te emeroje kur është rasti arbitrave pajtues e te nënshkru kompromise so,dhe te beje transaksione.

- te meroje drejtore administrative e nenpunesa te ranxheve te ndryshme.

- ky percaktim per kompetencat e organit administrativ është tregues jo taksativ.

neni 12

PERFAQËSIMI

furma he perfaqësimi i shoqerise perballë të treteve, dhe perpara gjygjitështëe drejte dhe detyre e dministratorit te vetem.

KREU IV

Neni 13

VETI FINANCIARE LLOGARITE VJETORE

Cdo vit financiara fill n me daten 1 janare he perfundon me daten 31 dhetor, pejashtimisht viri i pare financiare, mund te filloje pas një anarit dhe do te perfundoje me 31 dhetore te vitit në

zh

llogarite vjetorë, inventaret ,raportet mbi oparecionet e kryera dhe raportet e veçanta, ose eventualisht edhe nga eksperti kontabel, miratohen nga ortaku i vetem, miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore, behet mb rënda një afati gjatëmujoren nga data e mb lljes së vitit vinanciare.

neni 14

FITIMI

Fitimi neto i bilancit shperndahet si vijon:

a)5% destinohet per te krijuar fondin e rezerves së thjeshte. derisa ky te mbërrije, në një te pesten e kapitalit themeltare. ose qa sa ortaku i vetem, do ta quaj te nevojshem, rast pas rasti, në rast se rezerva është ulur nën një te pesten, deri sa te intregrohet e tera.

b) Mbetja te s hpern dahet konfrom vendimit te ortakut te vetem

neni 15

ZGJATJA E AFATIT

Zgjatja e faatit te shoqerise që është percaktuar në ëtë statut mund te vendoset nga ortaku i vetem.

neni 16

PRISHJA

Shoqeria prishet me perfundimin e afatit te percaktuar në nenin 4 te këtijë statuti.me perjashtim te ra te ve,.kur bëhet zgjatja e afat sipas neneit 4, kur ka prishje te parakoheshme, per arsye që parashikoh në ligj.

KREU V

Dispozitata e findit.

neni 17

SHTIMI I ORTAKËVE

Kur ortaku i vetem ështe dakort që të behet shtesë kapitali me anë të personave te tjerë ,që këto të konsiderohen ortakë veprohet kështu/

a) së pari shqyrtohet kërkesë me shkrim e te interesuarit, merret vendim nga ortaku i vetem, bëhet pran imi e percaktohet kuota e kapi lit, që do te lërë ortaku i ardhshëm.

b) së dyti; bëhet rregjistrimi në lib rin e ortakëve, ku shkruhe emri i plote dhe kuota që i perket në kapitalin themeltare.

c) së treti veprimi i bashkimit te ortakut të i behet me akt noterial.

neni 18

AMENDAMENTET

Këtijë akti(Statuti) mund ti behen amendamente, sa here që ortak i vetem e shef te arsyeshme.

neni 19

xKo VENDI DHE KOHA E HARTIMIT TE STATUTIT

Ky statut u hartua në Shkoder me dt 9.9.1995 në tre ekzemplare në gjyhen shqipe, duke patur te gjitha tekstet të njëjten vlerë.

ORTAKU I VETËM

Xhevdet Amali.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA SHKODER

Nr Repertori 1360
nr Koleksioni 971

AUTENTIFIKIM NËNSHKRIMI

Sot me daten 9.9.1995 diten e shtunde dhe para meje noteres Berhan Malevi, u paraqit Xhevdet Amali, per identitetin e te cilit pasi u sigurova në baze te leter njoftimit personal, i vertetova këtë nënshkrimi akti.

NOTERIA BERHAN MALEVI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E DREJTESISE

ZYRA HIPOTEKES SHKODER                    Shkoder, me 30 janar 1998

# VERTETIM PRONESIE

Ne favorin e zotni XHEVDET ARIF AMULI, prane kesaj Zyre, ne radhorin e pronesise nr. 466 date 18 mars 1996, eshte rregjistruar prona e poshteshenuar: . . . . . . . . . . . . . . . .

Nje pike karburanti e perbere prej salles se sherbimit dhe wc, me sip. 56(pesedhjete e gjashte) meter katror, verande 169 $m^2$ ( njeqind e gjashtedhjete e nente) meter katror, dhe depo e çisternave me sip. 130(njrqind e tridhjete)meter katror, e ndodhur ne lagjen "Pazari i Vjeter", Xhabiej, Shkoder, dhe e kufizuar: para rruga nacionale, prapa rruga e vjeter Tophane- Pazari i Vjeter, djathtas kanali kullues te Ura e Magjypit, majtas prona e Lavdi Shanes. . . .

Prona nuk ka asnje barre apo ipoteke. . . . . . . . . . .

I P O T E K U E S

ARBEN SALIM KOPLIKU

[illegible]OMA E NOTERISE KORCE
NOTERE PUBLIKE
NR. 877 Rep.
NR. 331 Kol.

831

## KONTRATE SHIT-BLERJE

Sot me daten 10.9.1994 (Dhjete shtator Njemije e [illegible] e pentedhjet e katert) diten e [illegible] [illegible] meje ZHULIETA ILIA MANO, me detyren e Noteres u paraqiten personalisht palet:

SHITES: SPATTAK DEVOLLIU, i biri [illegible], me datlindje 1967, banues ne Korce, madhor, i afte per te kryer veprime juridike, i pa njohur prej meje per identitetin e te cilit u sigurova me ane te leter njoftimit perkates.

BLERES: XHEVDET ANULI, i biri [illegible], me datlindje [illegible], banues ne SHKODER, i gjuezile, madhor, i afte për te kryer veprime juridike, i pa njohur prej meje për identitetin e te cilit u sigurova me ane te leter njoftimit përkates.

Palet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shit-blerje me përmbajtjen qe vijon:

Shitesi deklaron se eshte pronar i nje makine te tipit BENS me Nr.shasie WDB1241201A222716, me targe 39 KO 074, te cilen eshte plotesisht dakord qe t'i a shese bleresit XHEVDET ANULI përkundrejt vleres 800.000 (teteqind mije) lek, vlere e cila eshte shlyer jashte kesaj zyre.

Nga ana tjeter bleresi XHEVDET ANULI eshte plotesisht dakord qe te blere makinen e përshkuar me lart përkundrejt vleres se sipërme vlere e cila eshte shlyer jashte kesaj zyre dhe mbas ketij veprimi si behet pronar i kesaj makine.

Me sipër lexohet kjo Kontrate shit-blerje me përmbajtjen e te ciles palet jane plotesisht dakord dhe e nenshkruan ate rregullisht para meje.

P A L E T

SHITES: SPARTAK DEVOLLI BLERES XHEVDET ANULI

N O T E R E
ZHULIETA ILIA MANO

SH.P.K. "ARIFI"
IMPEX
SHKODER-ALBANIA

NOTERE KORÇE

NOTERE
ENGJËLLUSHE (?) SHKRELI
VERTETOHET NJESIA ME ORIGJINALIN

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Firma "Arifi" Sh.p.k., Shkoder

VENDIM NR. 4

I ORTAKUT TE VETEM

Me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane nr. 12131 date 18. 9. 1995, eshte rregjistruar Shoqeria "Arifi" Sh.p.k., Shkoder, me objektin e ditur, e seli ne Shkoder, dhe me administrator dhe ortak z. Xhevdet Arif Amuli.

Ndersa me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 12131/1 date 28. 3. 2002, eshte rregjistruar vendimi i Ortakut te vetem nr. 1 date 20. 1. 2002, per caktimin e ekspertes kontabel; kurse me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 12131/2 date 3 Maj 2002, eshte rregjistruar vendimi i Ortakut te Vetem nr. 2 date 29 Mars 2003 per shtimin e kapitalit themeletar te Shoqerise.

Ne mbledhjen e dates 11 Qershor 2004, u be analiza e punes se bere, dhe per te shtuar aktivitetin e Shoqerise dhe ne fushen e ndertimeve, u shqyrtua kontrata e punes nr. 1096/604 date 11 Qersh. 2004.

Keshtu,

U Vendos :

1. Miratimi e shteses se aktivitetit te Firmes dhe ne fushen e ndertimeve.
2. Depozitimi i ketij vendimi prane rregjistrit tregtar te Gjykates se Tiranes.

Kete vendim e nenshkruaj si poshte vijon :

Administratori

Xhevdet Amuli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA NOTERISE SHKODER

Nr. rep 1098

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Ne Shkoder, dhe para meje Arben Salim Kopliku, noter, me seli ne lagje Q. Stafa, rruga D. Bosko, sot me date 11 Qershor 2004, u paraqit personalisht zotni Xhevdet Arif Amuli, dtl, 1964, lindur e banues ne Shkoder, lagja "Guerile", administrator i pergjithshme i firmes "Arifi" sh.p.k., Shkoder; i njohur prej meje si i tille, madhore, e me zotesi te plote juridike per te vepruar, sipas kerkeses, vertetoj nenshkrimin e hedhur me siper:

**Arben Salim Kopliku**
**N o t e r**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE SHKODER

Nr. rep. 1096 Nr. kol. 604
Kontrata leke 2.000
Pulla takse 150
Shuma leke 2.150

# KONTRATE PUNE

Ne Shkoder, sot me dt. 10 Qershor 2004(dymije e kater), dhe para meje noter **Arben Salim Kopliku**, u paraqiten personalisht palet kontraktuese, si me poshte:

PUNEDHENESI : **Firma "Arifi" sh.p.k., Shkoder,** e perfaqsuar nga z. Xhevdet Amuli, Administrator i pergjishem, me seli..........................................

PUNEMARRESI: **Medo Shyqyri Pirani**, dtl. 25 Shtator 1951, lindur e banues ne Shkoder, lagja V. Kushi, rruga R. Tyli, Shkoder. me profesion ing. ndertimi..............

Per identitetin e te cileve u sigurova ne baze te leternjoftimeve te tyre personale dhe pasi konstatova se i kane te gjithe aftesite e kerkuara nga ligja, me kerkese te tyre, i redaktova kete kontrate pune, si me poshte vijon:..........................................................................

Punedhenesi puneson me detyre **ing. ndertimi, drejtues teknik**, i cili do te punoje per llogari te punedhenesit per periudhen kohore **dy vjet**, qe fillon nga data e sotme, kundrejt nje page mujore prej 20.000 leke, page kjo qe punedhenesi e paguan nje here ne muaj, dhe do te respektoje te gjitha rregullat e punes, dhe mban pergjegjesi per çdo shkelje, duke u marre ndaj tij mase administrative sipas K, Punes....................

Punedhenesi eshte i detyruar t'i siguroje punemarresit kushtet e nevojshme te punes, dhe t'i garantoje atij dhe detyrimet e tjera ne lidhje me shperblimin dhe pagen...

Kontrata lidhet me pelqimin e te dyja paleve, dhe zgjidhet po me pelqimin e tyre.

Kjo kontrate, pasi u lexue nga palet ne prezencen time, te cilet duke u gjendur konform kerkimit dhe vullnetit te vet te plote, po ne prezencen time, e pranuan ate dhe e nenshkruan si me poshte rezulton : ..........................................................................

PUNEDHENESI
Firma "Arifi" sh.p.k., Shkoder
Perf. nga admin. z. Xhevdet Amuli

PUNEMARRES
ing. Medo Pirani

**Arben Salim Kopliku**
**Noter**

# KERKESE

**KERKUESI** **Xhevdet Amuli**, i biri i Arif e Sulltane, i lindur me 16.12.1964 dhe banues ne Shkoder, me pasaporte sherbimi nr 0012793 e nr personal 00037S1SAMUXHE..........

**OBJEKTI** : Depozitimin e Vendimit Nr.03 date 29.06.2005 te Ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI" Shkoder

**BAZA LIGJORE**: Ligji Nr.7667 dare 28.01.1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin Tregtar"

**PERPARA** Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit

**Tirane**

I nderuar z. Kryetar,

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI" me ortak te vetem z. Xhevdet Amuli, e njohur kjo shoqeri si person juridik me vendimin e Gjykates Tirane nr. 12131 date 13.09.1995 me seli ne Shkoder, me vendimin e Ortakut te vetem te kesaj shoqerie nr.03 date 29.06.2005 eshte vendosur:

1. Emerimi konkret i Ekspertes Kontabel te Autorizuar Eftali Qiriaqi

2. Ekspertja kontabel e autorizuar te vleresoje rritjen e kapitalit ne vlere te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI" Shkoder, duke transferuar nje pjese te fitimit dhe llogarine fitime te mbajtura per rritje te kapitalit themeltar.

3. Te kerkoje depozitimin e vendimit nr 03 date 29.06.2005 te ortakut te vetem te "ARIFI" sh.p.k. ne zyren e Rregjistrit Tregtar prane gjykates se rrethit Tirane.

Kerkoj depozitimin e ketij vendimi duke bere ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie prane Zyres se Rregjistrimit Tregtar te Gjykates se rrethit Tirane .

**K E R K U E S I**
**Xhevdet Amuli**

SH.P.K.ARIFI
M.P
SHKODER-ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Dhoma e Noterise Shkoder
Nr 1530 Rep

# VERTETIM

Sot, me daten 29.06.2005(dymije e pese), para meje notere Valbona Hajdari, u paraqit personalisht: Ortaku i vetem i shoqersie me pergjegjesi te kufizuar "ARIFI":

